



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr.94, Datë 14.08.2008

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT NR. 8, DATË 17.12.2007 “MBI MARRJEN E MASAVE PËR KORRIGJIMIN E SITUATËS PROBLEMATIKE QË PARAQITET NË TREGUN E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MTPL”

Në bazë të nenit 14 dhe 32 të Ligjit nr.9572 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Rregullores datë 07. 05. 2002, të Ministrit të Financave “Për disa shtesa në Rregulloren 622/1 datë 15.12.1992 dhe në Urdhërin Nr. 82, datë 19.06.2008 të Ministrit të Financave “Për miratimin e primit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:

V E N D O S I:

- 1. Pika 1, paragrafi 6 i Vendimit të Bordit nr. 8, datë 17.12.2007, të ndryshojë si vijon:**
 - Cdo agjent ose punonjës në ambientet që ushtron veprimtarinë të ketë të afishuar në vende të dukshme:
 - Aneksin 1 me tabelat 1, 2 dhe 3 të primeve, të cilat publikohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe përditësohen prej tij në funksion të ndryshimeve të kuadrit ligjor që lidhet me to.
 - kopje të kushteve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm.
 - licencën e agjentit, ose autorizimin e punonjësit për të nënshkruar kontrata sigurimi.
- 2. Përditësimin e Aneksit 1 me tabelat 1, 2 dhe 3 të primeve për të pasqyruar ndryshimet që vijnë nga hyrja në fuqi e Urdhërit Nr. 82, datë 19. 06. 2008 të Ministrit të Financave “Për miratimin e primit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.**
- 3. Publikimin në faqen e internetit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në seksionin e përbashkët të shoqërive të sigurimit të këtij vendimi dhe të Aneksit 1 të përditësuar.**
- 4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.**

5. Ngarkohet Drejtoria IT, të reflektojë të gjitha ndryshimet në zbatim të këtij vendimi, në Rregjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik.
6. Vendimi u bëhet i njohur të gjitha shoqërive të sigurimit.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

NENKRYETAR
Ermela GUXHOLLI

NENKRYETAR
Keler GJIKA